

RAPORT MUJOR PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Rëndësia e Kapitullit 23

Në muajin prill të vitit 2020, Komiteti i Helsinkit vazhdoi me monitorimin e masave të Qeverisë, veçanërisht në kontekst të respektimit të drejtave themelore në suaza të Kapitullit 23. Duke marrë parasysh këtë më lartë dhe duke ndjekur zhvillimin e ngjarjeve, Komiteti i Helsinkit bëri thirrje për respektimin e të drejtave të njeriut përmes informacionit në kohë dhe transparent për publikun me informacion të saktë, me qëllim të rritjes së mbikëqyrjes publike të ekzekutivit gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

DISKRIMINIMI

PUNONJËSET NË SHËNETËSI PUNOJNË PANDËPRERË NË SPITAL DHE NË SHËTËPI



Gratë në nivel global përbëjnë mbi

70%
të punonjësve në shëndetësi



Ato ballafaqohen me:

mbingarkesë të dyfishtë

turne më të gjata në vendin e punës

kujdes plotësues në suaza të shtëpisë

punë të papaguar shtëpiake



4 orë dhe 25 minuta



1 orë dhe 23 minuta

Kjo pandemi edhe njëherë na kujtoi për rëndësinë e punëve shtëpiake të paguar dhe të papaguar, dhe nëse duam të dalim nga kjo krizë me një shoqëri më të drejtë, do të jetë e nevojshme që gratë të përfshihen maksimalisht në krijimin e politikave për COVID-19.

BARAZIA GJINORE

MBROJTJA E VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE NË KUSHTET E PANDEMISË

Masat kufizuese të miratuara për çdo ditë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për të mbrojtje kundër COVID-19 kontribuojnë seriozisht në rritjen e rrezikut të dhunës në familje.

Të dhënat i konfirmojnë problemet shumëvjeçare me:

mosdenoncimin nga ana e viktimave

mënyrën jo përkatëse të regjistrimit të veprave penale

menaxhimin e statistikave të zbërthyera sipas gjinisë

mënyrën jo përkatëse të kualifikimit të rasteve të dhunës në familje (shpesh trajtohen si kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike)

Qeveria miratoi një dekret me të cilin gratë viktimë dhe fëmijët e tyre që e lëshojnë shtëpinë për shkak të kanosjes ose rrezikut të drejtpërdrejt nga dhuna, gjatë orës policore mund të udhëtojnë pa pengesa deri te stacioni më i afërt i policisë, ose nëse ata kanë nevojë për kujdes shëndetësor deri te institucioni më i afërt shëndetësor.



janë regjistruar **79** vepra penale për dhunë të kryer në familje

28% e njëta periudhë vitin e kaluar

PERSONAT ME PENGESA (AFTËSI TË KUFIZUARA)

ARSIM INKLUZIV



fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, veçanërisht fëmijët me aftësi të kufizuara, gjatë kohës së pandemisë përballen me sfida shtesë, platformat arsimore në internet që kanë zëvendësuar arsimin e rregullt me fillimin e izolimit, i përjashton numrin më të madh të tyre.

ua përkujtojmë institucioneve përgjegjëse që ata duhet të përipien sa më shpejt të jetë e mundur të miratojnë akte nënligjore për të siguruar zbatimin e duhur të Ligjit dhe përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në procesin arsimor nga çdo aspekt.

LËVIZJA E PERSONAVE ME PENGESA GJATË KOHËS SË ORËS POLICORE




është miratuar një dekret me të cilin u përcaktuan disa orare kohore gjatë ditës në të cilin personat me aftësi të kufizuara do të jenë në gjendje të lëvizin lirshëm

GRATË PUNËTORE NË INDUSTRIJË DHE TEKSTILIT

GRATË PUNËTORE NË INDUSTRIJË DHE TEKSTILIT NUK JANË TË MBROJTURA MJAFTËSHËM NGA INFECTIMI I MUNDSHËM ME VIRUSIN KORONA NË VENDIN E PUNËS

numri i shtuar i denoncimeve për mosrespektimin e dekreteve për organizimin e procesit të punës dhe transportit të punëtorëve gjatë kohës së orës policore nga ana e punëdhënësve.



Procesi i punës është organizuar në atë mënyrë që nuk respektohet distanca



gratë punëtore transportohen në autobusë të papërshatshëm gjatë kohës së orës policore nga ana e punëdhënësve.

Detyrat e punës dhe punëdhënësit, nuk u ofrojnë grave punëtore në industrinë e tekstilit pajisje të domosdoshme mbrojtëse gjatë punës.

Ne i bëjmë thirrje Inspektoratit Shtetëror të Punës që të rrisë numrin e mbikëqyrjeve inspektuese me detyrë zyrtare në punëtoritë e tekstilit, veçanërisht në ata që punojnë gjatë kohës së orës policore, në mënyrë që të sigurohet respektimi i përpiktë dhe i vazhdueshëm i dekreteve për organizimin e procesit të punës dhe transportimin e punëtorëve, dhe kështu të sigurohen kushte të shëndetshme dhe të sigurta të punës për punëtorët në industrinë e tekstilit.

